



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË



Drejtoria për Arsim dhe Edukim

Nr. 11/47

Datë: 27/01/2017

Mbështetur në nenin 12 par. 12.2 shkronja (c dhe d), neni 13, 17 shkronja (h) 24 dhe neni 58 (shkronja b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, Vendimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës nr.01/55, dt. 23.01.2017, dhe Rregullores së Kuvendit të Komunës me numër 02/333, të datës 17.12.2015

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim me datë 27 .01. 2017 mori vendim për ;

SHPLLJEN E KONKURSIT

PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTET E KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN AKADEMIK 2017

Të gjithë studentët/et e rregullt, të Komunës së Malishevës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, racore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultetet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përfshirë studentët në studime Pasuniversitare-Master dhe Doktoraturë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave-subvencioneve për studime të rregullta.

Për këtë qëllim, Komuna e Malishevës do të ndajë gjithsejtë pesëdhjetë (50) bursa në vlerë prej pesëdhjetë euro(50 €) , për një muaj, dhe e njëjta do të ndahet për muajt (Janar –Qershor).

Kriteret e përgjithshme për të fituar bursën-subvencionin nga Komuna e Malishevës :

- Studentët që studiojnë në Universitetet Publike,
- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Malishevës,
- Studentët të cilët janë dy (2) e më tepër nga e njëjta familje,
- Shfrytëzues të bursës studentore mund të jenë vetëm studentët rregullt,
- Studentët që janë shfrytëzues të bursës Universitare apo ndonjë burse tjetër nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të kësaj burse,
- Studentët që janë në marrëdhënie pune nuk mund të jenë përfitues të bursës,
- Prioritet kanë studentët e familjeve të dëshmorëve,invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së, me gjendje të rëndë ekonomike si dhe rastet sociale, të cilat duhet të vërtetohen me dokumentacion përkatës!

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

- Certifikata e notave (originale), së bashku me kopjen e indeksit me të gjitha provimet e dhëna,
- Kopja e letërnjoftimit,
- Deklarata e bashkësisë familjare
- Certifikatën e vendbanimit
- Diplomat, mirënjohjet, certifikatat për suksesin e arritur në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.
- Dëshmia se është invalid i luftës, apo veteranë i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, i veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me nevoja të veçanta dhe se është nga familja përfituese në skemën sociale.
- Vërtetimi se studenti/ja ka regjistruar vitin akademik 2017 (i rregullt).

Vërejtje : Bursat ndahen për afatin kohor retroaktiv : **01.01.2017** deri më **30.06.2017** (për gjashtë muaj).

- a. Te studentët e një profili me kushte të barabarta do të merret për bazë mesatarja më e lartë e notave profesionale.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim deri më datë, 11.02.2017, (15 ditë kalendarike) duke filluar nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve të Komunës së Malishevës. Dokumentet pas aplikimit nuk kthehen, kështu që duhet të jenë të fotokopjuara për ato që mendoni të i posedoni më tej.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara duhet të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Malishevë (objekti i ri i administratës) .

Të gjitha kërkesat e parashtruara do të shqyrtohen nga komisioni përkatës.

Malishevë, 27 janar 2017

Drejtori

Avdi Morina
